



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**Qeveria -Vlada - Government**

***Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede,  
Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry And Rural  
Development***

Duke u bazuar në nenin 1.3 pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë dhe nenin 28 Ligjit Nr. 2004/21 për Veterinarinë të datës 30.07.2004, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,  
Nxjerr sa vijon:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR.19/2008**

**Për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ MA-NR. 26/2005  
Mbi masat për monitorimin e materieve të caktuara dhe mbetjeve të tyre në kafshët  
e gjalla dhe produktet me prejardhje shtazore**

**Neni 1**

Udhëzimi Administrativ MA-Nr. 26/2005 i dt. 19 Dhjetor 2005 mbi masat për monitorimin e materieve të caktuara dhe mbetjeve të tyre në kafshët e gjalla dhe në produktet me prejardhje shtazore, ndryshohet dhe plotësohet sa vijon:

**Neni 2**

Në nenin 19, paragrafi 1 fshihet dhe zëvendësohet me tekstin: “Koston e hulumtimeve dhe analizave laboratorike i bart organi kompetent”.

**Neni 3**

Në nenin 19, paragrafi 2, fshihet.

**Neni 4**

Nenit 25, i shtohet paragrafi 2 me tekstin:“duhet të hulumtohet, se cili person fizik apo juridik e ka furnizuar fermën me materie të ndaluara, dhe të ndërmerren të gjitha masat ndëshkuese ligjore ndaj furnizuesit”.

**Neni 5**

Paragrafi 2 i nenit 25 bëhet paragrafi 3.

**Neni 6**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

Prishtinë 31.03.2008

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
Ministri,  
Idriz Vehapi

---